



# A i njihni të drejtat tuaja?

**LIBËR INFORMIMI PËR TË  
DREJTAT E TË DËNUARVE**

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



Zyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Programeve  
Këshilli i Evropës  
Avenue de l'Europe (F-67075 Strasbourg Cedex)

<https://horizontal-facility-eu.coe.int>

Facebook: [jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)

Twitter: @CoE\_EU\_HF

Ky publikim u përgatit në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019 – 2022” dhe projektit “Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të dënuarve në Shqipëri”

© 2020 Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme ose përmes çfarëdo mjeti, qoftë elektronik (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çfarëdo sistemi depozitimi ose marrjeje informacioni, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)).

Kjo broshurë u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë rast nuk mund të merren bazë për të reflektuar opinionin zyrtar të asnjë pale.

---

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



---

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës

# LIBËR INFORMIMI PËR TË DREJTAT E TË DËNUARVE

Autor:

**Ëngjëll Hysi**

Konsulent i Këshillit të Evropës



# PËRMBAJTJA E LËNDËS

<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
<b>1. JETA NË INSTITUCION</b> .....	<b>5</b>
1.1 Vendosija në institucion .....	5
1.2 Pranimi në institucion .....	6
1.3 Arsimimi, trajnimi dhe veprimtaritë e tjera .....	9
1.4 Letrat, korrespondenca dhe mbajtja e kontakteve .....	10
1.5 Kujdesi shëndetësor .....	11
1.6 Të dënuarat gra .....	14
1.7 Të dënuarit e huaj .....	15
<b>2. SIGURIA NË INSTITUCION</b> .....	<b>15</b>
2.1 Rregulli dhe siguria në institucion .....	15
2.2 Procedura e transferimit dhe lejeve .....	17
2.3 Procedura e uljes së dënimit dhe lirimit me kusht .....	20
<b>3. DISIPLINA NË INSTITUCION</b> .....	<b>22</b>
3.1 Rregullat në institucion dhe respektimi i tyre .....	22
3.2 Procedura e shqyrtimit të masave .....	23
3.3 Masat disiplinore .....	24
3.4 E drejta e ankimit .....	25
<b>4. E DREJTA PËR KËRKESË DHE ANKESË</b> .....	<b>25</b>
4.1 E drejta për të paraqitur kërkesë/ankesë .....	25
4.2 Komunikimi me institucionet e të drejtave të njeriut.....	27
4.2.1 Komunikimi me Avokatin e Popullit .....	27
4.2.2 Komunikimi me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.....	28
4.3 Komunikimi me organizatat vendase të të drejtave të njeriut .....	29
4.4 Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës .....	30
<b>5. AKSESI NË GJYKATË</b> .....	<b>30</b>
5.1 Çështjet për të cilat mund t'i drejtoheni gjykatës .....	30
5.2 Mbrojtja juridike .....	32
5.3 Kërkesa në Gjykatë Kushtetuese .....	34
5.4 Kërkesa në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	35
<b>SHTOJCA</b> .....	<b>36</b>
Kontakte të nevojshme.....	36
Formular Ndihma Juridike parësore.....	37
Formular Ndihma Juridike dytësore.....	40
Formular Përrjashtimi nga Tarifat Gjyqësore .....	44
Formular Vetëdeklarim të Ardhura Pasuri .....	47
Formular Vetëdeklarim Kategoritë e Veçanta .....	52



## HYRJE

Kjo broshurë është zhvilluar dhe mundësuar si pjesë e Projektit “Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të të dënuarve në Shqipëri”, pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”. Broshura ka për qëllim informimin e të dënuarve dhe familjeve të tyre mbi të drejtat dhe procedurat në institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim. Broshura informative shpjegon disa prej të drejtave të të dënuarve të cilat shkelen me shpesh në praktikë dhe mekanizmat që duhet përdorur për t’i mbrojtur ato. Në këtë broshurë shpjegohen procedura të ndryshme brenda dhe jashtë sistemit të burgjeve që mund të përdoren për të mbrojtur të drejtat e të dënuarve. Me qëllim ofrimin e ndihmës për të dënuarit, botimi përmban informacion për institucionet, ku të dënuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre mund të adresojnë një kërkesë ose ankesë, në rast se të drejtat e tyre nuk respektohen në institucion.

Kjo broshurë ka si qëllim të asistojë të dënuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre, por nuk merr përsipër të jetë gjithëpërfshirëse dhe nuk zëvendëson kodet, ligjet dhe rregulloret të tjera në fuqi.

Në raste të ushtrimit të të drejtave para institucioneve, një i/e dënuar, anëtar i familjes së tij/saj, ose avokat mbrojtës duhet ti referohet ligjit ose rregullores në fuqi.

## 1. JETA NË INSTITUCION

### 1.1 Vendosja në institucion

#### **A i humbas të drejtat e mia, nëse dënohem me burgim?**

Kur gjykata jep dënim me burgim dhe vendos që ju të qëndroni në burg, disa nga të drejtat tuaja kufizohen. Gjithsesi ju keni të drejtë të trajtoheni me dinjitet dhe të ushtroni të drejtat e përcaktuara nga ligji për trajtimin e të dënuarve, pa diskriminim. Gjatë qëndrimit në institucion ju gjithashtu gëzoni të drejta dhe liri të tjera si: e drejta për trajtim njerëzor, e drejta për kujdes shëndetësor, liria e shprehjes dhe e besimit, e drejta për familje, e drejta për proces të rregullt ligjor, e drejta për të mbajtur kontakte me familjen dhe të afërmit etj.

## Ku mund të kryej dënimin me burgim?

Si rregull, ju mund të kryeni dënimin në një institucion që ndodhet pranë vendbanimit të anëtarëve të familjes uaj. Në varësi të veprës penale të kryer, rrezikshmërisë së saj dhe tuajën, ju mund të vendoseni një një burg të sigurisë së ulët, të zakonshëm ose të lartë, institucion të hapur ose në regjim të posaçëm në një burg të sigurisë së lartë.

Kur gjykata jep vendimin dhe ajo vendos që ju të qëndroni në një burg të sigurisë së lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, bazuar në vendimin e gjykatës dhe kriteret që përcakton ligji, cakton institucionin ku do të kryeni dënimin.

Kur gjykata nuk vlerëson se duhet të qëndroni në një institucion të sigurisë së lartë, lloji i burgut mund të caktohet nga prokurori dhe institucioni konkret nga drejtoria e burgjeve.

Vendosja në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë bëhet nga Ministri i Drejtësisë, kur e kërkon drejtuesi i prokurorisë së posaçme dhe vetëm për disa vepra të rënda ose kur ju paraqitni rrezikshmëri të lartë.

## Si duhet të trajtohem, ndërsa lëviz për/nga institucioni?

Gjatë dënimit tuaj ju mund të lëvizni për arsye të ndryshme si për shembull, të shkoni në gjykatë, për kontroll shëndetësor, për veprimtari kulturore ose sportive jashtë burgut. Sa herë lëvizni, ju jeni i shoqëruar nga personeli i sigurisë së burgjeve i cili ka detyrim të marrë masa që ju të mos dalloheni nga publiku ose media. Lëvizja juaj duhet të jetë e sigurtë dhe të bëhet në kushte të përshtatshme për shëndetin tuaj. Për shembull, nëse është nxehtë ose ftohtë, temperatura në mjetin e transportit duhet të jetë e përshtatshme.

## 1.2 Pranimi në institucion

### Çfarë duhet të di për momentin e pranimit në institucion?

Sapo mbërrini në institucion, një komision do t'ju presë. Ju do të lejoheni të njoftoni familjarët ose ndonjë të afërm për - institucionin ku ndodheni. Pas marrjes së të dhënave si: emri, mbiemri, mosha, besimi, kontaktet e të afërmeve tuaj, vendimi, dënimi i dhënë, menjëherë do t'i nënshtroheni kontrollit mjekësor. Ju duhet t'i bëni me dije komisionit nëse:

- gjatë lëvizjes për në institucion jeni keqtrajtuar;
- vuani nga ndonjë sëmundje kronike ose jeni nën trajtim mjekësor;
- jeni në varësi të drogës ose alkoolit;
- keni qenë të dënuar më parë;
- keni ndonjë problem hasmërie ose konflikt me persona në burg.



Këto të dhëna nevojiten për t'ju ndihmuar ju gjatë qëndrimit në institucion, për trajtimin mjekësor, nëse keni nevojë, dhe për të hartuar planin individual të trajtimit gjatë kohës së qëndrimit në institucion. Kontrolli mjekësor nuk duhet të kryhet në praninë dhe pjesëmarrjen e personelit jomjekësor. Prania e personelit jomjekësor lejohet kur e kërkon mjeku. Të dhënat mjekësore regjistrohen në dosjen mjekësore personale dhe mbahen nga personeli mjekësor.

### **Si duhet të veproj nëse jam keqtrajtuar jashtë ose brenda institucionit?**

Nëse gjatë kontrollit konstatohen shenja të dëmtimeve, personeli mjekësor harton një raport mjekësor që përshkruan dëmtimet, çfarë është konstatuar, fotografitë e dëmtimeve, përshkrimin e tyre, dëshminë tuaj, trajtimin ose mjekimin që jepet nga mjeku. Çdo dëmtim i dukshëm i konstatuar në momentin e pranimit në institucion duhet regjistruar. Raporti vendoset në kartelën tuaj personale dhe një kopje e raportit duhet t'ju vihet në dispozicion juve dhe avokatit tuaj. Kontrolli mjekësor bëhet edhe në rast se keqtrajtimi ndodh kur lëvizni jashtë institucionit ose gjatë qëndrimit në institucion.

Mos hezitoni të raportoni rastet e keqtrajtimit. Institucioni është i detyruar të marrë masë që ju të jeni të mbrojtur nga personeli ose persona të tjerë që ju kanë keqtrajtuar.

### **A do të informohem për të drejtat e mia?**

Po, kur mbërrini në institucion ju duhet të informoheni për të drejtat dhe detyrimet, rregullat në institucion, oraret e aktiviteteve. Nëse keni vështirësi për t'i kuptuar ato, kërkonit që ky informacion të jepet me gjuhë të thjeshtë. Nëse nuk dini shkrim dhe lexim, personeli duhet të japë informacionin në formë të kuptueshme. Për personat e huaj, informimi bëhet në gjuhën që ata kuptojnë.

Nëse keni vështirësi për të kuptuar rregullat dhe të drejtat, ato duhet t'ju shpjegohen në mënyrë të kuptueshme. Mos hezitoni të pyesni personelin nëse keni nevojë për tu informuar!

### **A mund të mbaj sendet personale?**

Po, me leje të personelit të institucionit ju mund të mbani disa sende personale si: veshmbathje, sende të përdorimit personal, ose objekte që kanë një vlerë të veçantë për ju, si: libra, ditar, fotografi, një libër fetar. Sendet e tjera personale regjistrohen dhe mbahen në një vend të posaçëm. Ju mund të mbani një pjesë të të hollave për nevoja ditore, pjesa tjetër depozitohen në llogarinë tuaj të kursimit. Familjarë ose miq mund të depozitojnë të holla në llogarinë tuaj bankare.

## **A mundet personeli të më kontrollojë fizikisht?**

Po, ju do të kontrolloheni sapo mbërrini në institucion, sa herë hyni dhe dilni nga institucioni ose kur ka dyshime se mbani sende të ndaluara. Gjatë kontrollit respektohet dinjiteti dhe privatësia juaj. Kontrolli duhet të bëhet nga persona të së njëjtës gjini.

Sapo të mbërrini në burg, do t'i nënshtroheni kontrollit personal dhe të sendeve personale për të parë nëse keni sende të ndaluara, të fshehura në trup, për shembull telefon, substancë narkotike etj. Nëse keni medikamente mjekësore ose jeni nën trajtim mjekësor, medikamentet dhe dosja personale mjekësore i jepet mjekut të institucionit. Ky informacion nuk mund të ndahet me persona të tjerë. Kontrolli nga policia ose personeli i burgut i pjesëve intime të trupit është i ndaluar. Vetëm kur ka dyshime për fshehje të sendeve të ndaluara, ky kontroll bëhet nga mjeku.

Personeli mund të kontrollojë edhe mjedisin ku qëndroni, nëse ka dyshime se mbani mjete të ndaluara si për shembull, telefon, lëndë narkotike, alkool etj. Nëse gjenden sende të tilla, ndaj jush merret masë disiplinore.

## **A mund të qëndroj në një dhomë individuale?**

Ligji e lejon, por për shkak të numrit të të dënuarve, shpesh kjo nuk është e mundur. Ju mund të ndani dhomën me të dënuar të tjerë, gjithsesi numri i personave duhet të respektojë një kubaturë jo më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m<sup>2</sup> për çdo të burgosur. Në rast se keni probleme të mëparshme ose të krijuara gjatë qëndrimit në institucion me një të dënuar, flisni me personelin në mënyrë që t'ju transferojnë në dhomë ose seksion tjetër.

Qëndrimi i disa të dënuarve në një dhomë të vogël, pa respektuar sipërfaqen e mjaftueshme për person mund të çojë në përkeqësimin e higjienës, së ajrit, të kushteve në dhomë dhe mund të përbëjë trajtim çnjerëzor. Nëse nuk keni shtratin tuaj, ka infektive me parazitë, ajrimi në dhomë nuk është i mjaftueshëm, mungon ngrohja ose ndriçimi, ka mungesë të higjienës në qeli si pasojë e përdorimit të shisheve për nevojat fiziologjike këto kushte mund të përbëjnë trajtim çnjerëzor ose poshtëruar dhe konsiderohet si shkelje e standarteve Evropiane. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka ndëshkuar shtetet, përfshirë edhe Shqipërinë për shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkak të mbipopullimit në burgje dhe kushteve të papërshtatshme të burgimit që ndikuan në shëndetin e personave të dënuar.

Nëse vendoseni në një dhomë ku ka më shumë të dënuar sesa e lejon sipërfaqja e parashikuar nga ligji ose mungojnë kushtet e higjienës, të ajrimit, ndriçimit natural etj. Ju keni të drejtë të ankoheni te drejtuesi i institucionit, te ministri i Drejtësisë, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin





e Torturës pranë Avokatit të Popullit ose në gjykatën e rrethit ku ndodhet institucioni.

Ju lutemi vini re se në të njëjtën kohë ju gjithashtu keni detyrim të kujdeseni për higjienën dhe të mbani të pastër dhomën tuaj dhe hapësirat e përbashkëta.

## **A mund të përzgjedh ushqimin?**

Jo, ushqimi përgatitet në institucion për të gjithë të dënuarit. Ju duhet të merrni një ushqim të shëndetshëm dhe të balancuar. Me leje të personelit ju mund të pranoni ushqime të lejuara nga familjarët ose të përgatisni vet ushqimin. Nëse i përkisni një besimi të caktuar fetar dhe nuk hani disa lloj ushqimesh, njoftoni personelin dhe ata duhet t'ju ofrojnë ushqim që respekton besimin ose kulturën tuaj. Nëse vuani nga një sëmundje dhe duhet të mbani një regjim ushqimor, ushqimi përgatitet sipas rekomandimeve të mjekut.

## **1.3 Arsimimi, trajnimi dhe veprimtaritë**

### **Çfarë mund të bëj gjatë ditës?**

Në varësi të regjimit të institucionit, ju mund të merrni pjesë në aktivitete bazuar në programin që personeli ka hartuar për ju dhe në veprimtari me të dënuar të tjerë.

Ndjekja e kurseve profesionale, marrja pjesë në programe trajnimi, veprimtari kulturore, sportive, leximi i librave, kryeja e punëve të ndryshme si: pastrimi i dhomës, ambjenteve të përbashkëta janë pjesë e programit ditor. Pjesëmarrja juaj në to shënohet në raportin e vlerësimit që harton personeli për ju. Ky raport shërben për shembull, për lejet shpërblyese, uljen e dënimit, transferimin në një burg me regjim më të ulët, lirimin nga burgu para kohe.

### **Sa kohë mund të qëndroj në mjedis të hapur?**

Ju mund të qëndroni në ajrim, në mjedise të hapura, jo më pak se 2 orë në ditë. Ajrimi në mjedise të hapura çdo ditë është i detyrueshëm për çdo të dënuar, edhe nëse jeni vendosur në regjim të posaçëm ose jeni dënuar me burgim të përgjeshëm.

Koha e qëndrimit mund të ulët, por jo më pak se 1 orë në ditë për personat e vendosur në regjimin e posaçëm ose për shkaqe të veçanta ose rrethana të jashtëzakonshme. Nëse ulët koha e ajrimit, personeli duhet t'ju shpjegojë

arsyet e këtij vendimi. Koha që shpenzoni për bibliotekë, trajnime, kurse të mësimit të profesioneve ose të gjuhëve të huja, në aktivitete sportive ose kulturore nuk zëvendëson kohën e ajrimit.

### **A mund të ndjek arsimin ose kurse trajnimi?**

Po. Ju keni të drejtë të ndiqni shkollën nëse nuk e keni përfunduar. Çdo i dënuar duhet të lejohet të ndjek shkollën, trajnime ose të mësojë një profesion të caktuar.

Nëse nuk keni përfunduar arsimin 9 vjeçar dhe jeni nën moshën 18 vjeç, institucioni duhet të ofrojë arsimim brenda burgut ose në një shkollë, aty pranë, jashtë burgut. Me mbarimin e shkollës ju merrni deftesën dhe ajo nuk tregon se jeni i dënuar dhe se shkollën e keni kryer gjatë kohës së qëndrimit në burg.

Ju mund të vazhdoni shkollën e mesme ose të lartë ose të merrni pjesë në trajnime për të mësuar një profesion. Ju duhet të flisni me punonjës të edukimit në burg për interesat tuaja dhe mundësitë që ekzistojnë në lidhje me arsimin dhe kurset e trajnimit.

**Është në të mirën tuaj të vijoni arsimimin dhe të ndiqni kurse të ofruara nga institucioni për të mësuar një profesion. Pas mbarimit të dënimit, mundësitë për tu punësuar janë më të mëdha, nëse keni mësuar një profesion.**

## **1.4 Letrat, komunikimet dhe mbajtja e kontakteve**

### **A mund të komunikoj dhe të takohem me familjarë pa u kontrolluar?**

Po, ju keni të drejtë të komunikoni dhe takoheni me familjarët dhe të afërmit tuaj, sipas kriterëve të përcaktuara nga ligji. Çdo muaj ju keni të drejtën e të paktën katër takimeve me anëtarët e familjes me kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë. Institucioni duhet të sigurojë kushte sa më normale për takimin me familjarët.

Si rregull, bisedat telefonike me familjarët dhe personat e tjerë nuk kontrollohen, megjithatë telefonata juaj mund të kryhet nën vëzhgimin e një punonjësi. Telefonatat kryhen nga brenda institucionit sipas kohës së përcaktuar në rregullore. Nëse ju nuk keni mundësi financiare, institucioni ju jep një kartë me kredit telefonik ose siguron takime online nga institucioni.

Letrat nuk kontrollohen. Kur ka të dhëna që letra që vjen në adresën tuaj mund të ketë sende të ndaluara, letra hapet në praninë tuaj. Disa letra nuk duhet të kontrollohen si për shembull letrat për:



- avokatin mbrojtës;
- Avokatin e Popullit;
- organizatat ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

Përgjimi i komunikimeve dhe kontrolli i letrave ose e-maileve tuaja mund të bëhet në raste të kufizuara të caktuara në ligj, me vendim të prokurorit ose të gjykatës.

## Sa shpesh mund të takohem me mbrojtësin ligjor?

Ju keni të drejtë të takoheni me mbrojtësin ligjor:

- sa herë është e nevojshme;
- në çdo kohë të ditës;
- mund të komunikoni lirisht dhe vetëm për vetëm me të;
- bisedat ose komunikimi mes jush nuk lejohet të përgjohet;
- nuk lejohet kontrolli i korrespondencës dhe dokumentet ndërmjet jush, me përjashtim të rastit kur përbëjnë provë materiale në hetim;

Takimet me mbrojtësit nuk përlogariten në numrin e takimeve që lejohen gjatë muajit.

Nëse je shtetas i huaj, ju mund të kërkonti praninë e përkthyesit në takimin me mbrojtësit. Personeli i burgut do të marrë përsipër përgjegjësinë t'ju mundësojë atë. Nëse nuk dëgjoni dhe nuk flisni, ju do të ndihmoheni nga një interpretues i gjuhës së shenjave.

## 1.5 Kujdesi shëndetësor në institucion

### Për çfarë mund të flisni me mjekun e institucionit kur mbërrini në institucion?

Shërbimi shëndetësor ofrohet në institucion pa diskriminim. Është me rëndësi kontrolli shëndetësor në momentin e mbërritjes në institucion. Ky kontroll kryhet menjëherë, pas pranimit tuaj në institucion. Mos hezitoni të flisni me mjekun:

- për sëmundjet kronike;
- mjekimet që merrnit para mbërritjes në institucion;
- varësinë nga alkooli ose droga;
- sëmundjet seksualisht të transmetueshme;
- sëmundje infektive ose ngjitëse;
- nëse keni ankthe ose shqetësime të tjera;
- nëse keni shqetësime mendore;

- keni tentuar të dëmtoni veten;
- jeni abuzuar seksualisht ose jeni viktimë e ndonjë forme tjetër dhune.

### **Nëse kam varësi nga alkooli ose droga, a mund të përfitoj trajtim?**

Po, sapo mbërrini në institucion, flisni me mjekun dhe informoheni atë për problemet që keni. Ju duhet të trajtoheni në burg me të njëjtat programe shëndetësore dhe sociale që trajtohen personat jashtë burgut. Bashkëpunoni me personelin për të marrë trajtimin e detoksifikimit dhe përfshihuni në aktivitete sociale në institucion.

Ju lutem mbani parasysh që, konsumi i alkoolit ose i drogave nuk lejohet në institucion.

### **Çfarë ndodh nëse kam një sëmundje ngjitëse ose infektive?**

Nëse jeni në dijeni të sëmundjes, ju duhet të flisni me mjekun sapo të mbërrini në institucion. Nëse ka rrezik që sëmundja të shpërndahet dhe të infektojë të tjerë, ju mund të veçoheni nga të dënuarit e tjerë për të mos i infektuar ata dhe për t'u trajtuar për sëmundjen.

Nëse viheni në dijeni për sëmundjen gjatë qëndrimit në burg, ju duhet të flisni me mjekun dhe keni detyrimin të tregoni kujdes për të mos infektuar personat e tjerë. Flisni me infermierin ose mjekun për masat mbrojtëse që duhet të merrni dhe informohuni për sëmundjen. Përsonele mjekësore do t'ju asistojnë të bëni ekzaminimet dhe të merrni trajtimet mjekësore të nevojshme. Nëse jeni e dënuar, ju keni të drejtë të kontrolloheni rregullisht për të parandaluar infeksionet, kancerin e gjirit ose të mitrës. Nëse nuk ndiheni mirë me kontrollat shëndetësore nga një mjek, flisni me personelin mjekësor të mundësojnë vizita nga një mjeke.

***Mbani mend: Kujdesi për shëndetin tuaj është i nevojshëm për ju, familjarët tuaj, për personat e tjerë në institucion dhe për personelin.***

### **Konsultat dhe takimet me mjekun janë konfidenciale?**

Po, nëse ju keni nevojë të vizitoheni nga mjeku i institucionit, vizitat bëhen në një mjedis të posaçëm dhe në mënyrë individuale dhe jo në grup me të dënuarit e tjerë. Informacioni për sëmundjen dhe trajtimin e saj shënohet në kartelën tuaj mjekësore dhe mbahet nga mjeku në mënyrë konfidenciale. Ai nuk mund t'i japë informacion mjekësor personelit jomjekësor. Gjatë qëndrimit në institucion, çdo kontroll mjekësor nuk kryhet në prani dhe me pjesëmarrjen e personelit jomjekësor. Prania e personelit jomjekësor lejohet në mënyrë të veçantë vetëm kur e kërkon mjeku. Si rregull, ju keni



të drejtë të njiheni me përmbajtjen e kartelës suaj mjekësore. Ju mund të kërkonti që ky informacion t'i komunikohet familjes ose avokatit ose një mjeku jashtë institucionit.

Kërkesa juaj për vizitë ose konsultë me mjekun i drejtohet me shkrim ose me gojë personelit mjekësor të institucionit ose personelit të sigurisë në regjim.

## **Nëse kam nevojë për trajtim shëndetësor a mund ta marrë atë jashtë institucionit?**

Si rregull, shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen brenda institucionit ku gjendeni. Konsultat vizitat, shërbimet urgjente, shërbimi dentar etj. janë shërbime që duhet të ofrohen në të njëjtin institucion.

Në rast se shërbimi mjekësor për diagnostikimin ose mjekimin e një sëmundjeje nuk ju ofrohet nga institucioni, shërbimi shëndetësor ofrohet në qendrën spitalore të burgjeve dhe kur është e nevojshme, në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë, ose në institucionet spitalore rajonale.

Ju përfitoni pa pagesë të gjitha shërbimet që përfshihen në skemën e sigurimit shëndetësor nëse ofrohen në institucion, në qendrën spitalore të burgjeve ose në institucionet jashtë burgut, kur këto ekzaminime dhe mjekime nuk ofrohen nga institucioni.

Ju keni të drejtë të kryeni vizita mjekësore nga një mjek ose në një institucion të kujdesit shëndetësor jashtë sistemit të burgjeve, por brenda vendit, të zgjedhur prej jush. Në këtë rast ju duhet t'i mbuloni vetë shpenzimet mjekësore dhe çdo shpenzim tjetër që rrjedh si pasojë e zgjedhjes së mjekut nga ana juaj.

Nëse jeni duke kryer dënimin në një institucion të sigurisë së lartë, ju mund të përfitoni vizita mjekësore nga një mjek ose në një institucion të kujdesit shëndetësor të zgjedhur prej jush vetëm pas vlerësimit të rrezikshmërisë suaj. Nëse jeni të vendosur në regjimin e posaçëm brenda sigurisë së lartë, ju keni të drejtë të kryeni vizita mjekësore nga një mjek të zgjedhur prej jush ose në një spital në rast se shërbimi i kërkuar nuk ofrohet nga shërbimi i kujdesit shëndetësor në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe qendra spitalore e burgjeve.

Në rastet e trajtimit ose ekzaminimeve në spitalin e burgut ose në institucione të kujdesit shëndetësor jashtë sistemit të burgjeve, transferimi juaj bëhet nën shoqërinë e personelit mjekësor i cili mban edhe informacionin tuaj mjekësor, si dhe të personelit të sigurisë së burgjeve.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor në institucion duhet të ofrohen nga personel i kualifikuar. Standardet e shërbimit duhet të jenë të njëjta me shërbimet që ofrohen në institucionet e kujdesit shëndetësor jashtë

institucionit. Mungesa e kujdesit të duhur shëndetësor që mund të vendosë në rrezik jetën e të dënuarit, ose të dëmtojë shëndetin e të dënuarit, mund të përbëjë shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **Cilat janë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në burg?**

Personat me aftësi të kufizuar përfitojnë kujdes shëndetësor si të dënuarit e tjerë dhe në varësi të nevojave, duhet të trajtohen sipas standardeve të trajtimit jashtë institucionit. Si rregull, shërbimet e kujdesit shëndetësor për personat me aftësi të kufizuar duhet të ofrohen brenda institucionit. Nëse keni nevojë për terapi, fizioterapi ose shërbime të tjera, flisni me mjekun për të mundësuar këto shërbime brenda ose jashtë institucionit.

## **1.6 Të dënuarat gra**

### **Nëse jam grua e dënuar, si duhet të trajtohem në institucion?**

Krahas të drejtave që ka çdo i dënuar, trajtimi juaj varet nga nevojat specifike që kanë gratë. Gratë e dënuara e kryejnë dënimin në institucione të veçanta për gratë. Në Shqipëri, aktualisht ka një burg për gratë. Ligji kërkon që personeli t'ju ofrojë programe dhe shërbime sipas moshës dhe nevojave tuaja. Flisni me personelin mjekësor për shërbimet e kujdesit shëndetësor, për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, higjienën vetjake, për format e dhunës dhe çdo lloj abuzimi.

Nëse keni pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike, seksuale, kontaktoni me stafin mjekësor dhe psikologun për të hartuar së bashku programin e kujdesit shëndetësor dhe të trajtimit të pasojave të dhunës. Mos hezitoni të flasni me ta edhe për shqetësimet që mund të keni ose probleme të tjera me persona jashtë institucionit!

Institucioni duhet t'ju sigurojë kontrolle shëndetësore periodike ose sa herë që keni nevojë nga mjeku gjinekolog, psikiatër dhe kontrolle periodike për parandalimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve të kancerit të gjirit dhe sëmundjeve të tjera për gratë. Kontrollat periodike mbrojnë jetën tuaj!

### **Çfarë ndodh nëse jam shtatëzanë ose kam fëmijë të vegjël?**

Nëse jeni shtatëzanë në kohën e pranimit në institucion, stafi mjekësor do të zbatojë të gjitha rregullat për trajtimin e grave shtatëzanë jashtë burgut. Flisni me personelin shëndetësor, nëse keni probleme me ushqimin ose shqetësime të tjera.



Lindja e fëmijës bëhet në qendrat spitalore të lindjes së fëmijëve dhe jo në burg. Ju do të shoqëroheni rrugës nga personeli i sigurisë, por në mjediset e lindjes do të kujdeset personeli shëndetësor i spitalit.

Në rast se keni fëmijë deri në moshën 3 vjeç, ju lejohet ta mbani në institucion. Si rregull, gratë që jetojnë me fëmijën në institucion qëndrojnë në një mjedis të posaçëm për gratë me fëmijë. Si rregull, për fëmijën tuaj kujdesen edhe edukatorët dhe ka një çerdhe të posaçme.

Mund të konsiderohet si shkelje e të drejtave tuaja nëse një fëmijë të ndahet menjëherë pas lindjes nga nëna. Nëna dhe fëmija duhet të lejohen të rrijnë së bashku të paktën për një periudhë të caktuar kohe. Gjithësesi mund të ndodhë që fëmija të ndahet nga ju para së të mbushë moshën 3 vjeç, kur gjykata vlerëson se është në të mirën e fëmijës. Parimi udhëheqës duhet të jetë gjithmonë mirëqenia dhe interesi më i mirë i fëmijës. Gjykata merr vendimin bazuar në kërkesën e prindit tjetër, kujdestarit ligjor ose institucioneve për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo mund të ndodhë nëse mirëqenia e fëmijës dëmtohet në bazë të mungesës së mjedisit të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijës në institucionin e burgut ose ju keni probleme shëndetësore dhe/ose psikologjike dhe me sjelljen tuaj dëmtohet mirërritja e fëmijës. Nëse keni fëmijë të vegjël jashtë institucionit, ju mund t'i takoni ata gjatë takimeve me familjarët.

## 1.7 Të dënuarit e huaj

Si i dënuar i huaj, apo person pa shtetësi, cilat janë të drejtat e mia?

Ju gëzoni të gjitha të drejtat që gëzojnë të dënuarit e tjerë. Institucioni ka detyrim që të sigurohet se ju keni marrë gjithë informacionin e nevojshëm për të drejtat dhe detyrimet në institucion, me gojë dhe me shkrim, në një gjuhë që ju kuptoni. Menjëherë pas pranimit në institucion, drejtori i institucionit krijon mundësitë që ju të njoftoni familjen, përfaqësuesin ligjor, përfaqësuesin konsullor ose një organizatë që vepron në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

## 2. SIGURIA NË INSTITUCION

### 2.1 Rregulli dhe siguria në institucion

#### A mund të jem i sigurtë në burg?

Çdo i dënuar dhe vetë personeli duhet të ndihen të sigurtë. Personeli ka për detyrë të mundësojë rendin dhe sigurinë që jeta juaj dhe e çdo të dënuari

të mos vihet në rrezik, të mos kërcënoheni ose dëmtoheni nga të dënuarit e tjerë. Personeli duhet t'ju mbrojë nga përpjekjet tuaja për t'u vetëdëmtuar ose vetëvlarë.

Nëse keni shqetësime, kontakto me psikologun ose stafin mjekësor. Nëse personeli vë re se ju keni nevojë për trajtim për shkak të shqetësimeve, ankthit ose çrregullimeve mendore, një mjek i specializuar do t'ju vizitojë.

Nëse keni një konflikt të vjetër ose të ri me ndonjë të dënuar tjetër, shok dhome ose jo, flisni me personelin e sigurisë. Nëse konflikti është me një pjesëtar të personelit, kontakto me drejtuesin e institucionit. Bashkëpunimi me ta do të ndihmojë në zgjidhjen e konflikteve që ju dhe të dënuarit e tjerë të ndiheni më të sigurtë.

**Është e rëndësishme: Me sjelljen tuaj, komunikimin dhe respektimin e rregullave në burg, ju kontribuoni për sigurinë tuaj, të personelit dhe të dënuarve të tjerë.**

### **A lejohet përdorimi i forcës? Nëse po, në cilat raste?**

Si rregull, përdorimi i forcës nuk lejohet, me përjashtim të rastit kur punonjësi vetëmbrohet, ose ndërmer veprime që të ndalojë dhunën mes të dënuarve ose në rastet e tentativës për arratisje nga burgu. Në rast përpjekjeje për t'u vetëdëmtuar ose nëse përdorni forcën ndaj një të dënuari tjetër, apo personelit të institucionit, ndaj jush mund të përdoret forca, nëse ju nuk ndërprisni veprimet, pavarësisht paralajmërimeve të bëra.

Përdorimi i forcës duhet të jetë në minimum, proporcional dhe për një kohë të shkurtër. Në rast rezistence, mund të përdoren mjete shtrënguese ndaj jush si dhe t'ju veçojnë nga të dënuarit e tjerë, mund të propozohet fillimi i procedimit për një masë disiplinore ndaj jush ose mund të kërkohet vendosja juaj në mbikqyerje për një kohë të caktuar.

Në rast përdorimi force, punonjësi që ka përdorur forcën duhet të njoftojë me shkrim drejtorin e institucionit. Ju do të vizitoheni nga mjeku për të parë nëse keni dëmtime dhe nevojë për trajtim shëndetësor.

Përdorimi i forcës pa shkak, ose vijimi kur ka ndaluar shkak është shkelje e ligjit nga punonjësi i institucionit. Ju keni të drejtë të ankoheni të drejtuesi i institucionit ose në gjykatë, ose në institucionet të tjera si Avokati i Popullit ose në prokurori.

**Vini re : Është në të mirën tuaj që konfliktet që mund të lindin me të dënuarit e tjerë ose personelin, të zgjidhen me ndërmjetësim dhe mirëkuptim, për të shmangur përdorimin e forcës!**





## Në cilat raste mund të vendosem në mbikqyrje të veçantë?

Nëse me sjelljen tuaj përbëni rrezik për personelin e burgut, vizitorët, të burgosurit e tjerë, pengoni të burgosurit të zbatojnë rregullat ose nxisni shkeljen e tyre, drejtori i institucionit mund t'ju vendosë në një qeli të veçantë. Vendimi bazohet në raportin që përgatit Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve. Në varësi të sjelljes tuaj, ju mund të qëndroni nën mbikqyrje jo më shumë se tre muaj.

Kjo masë nuk është dënim disiplinor, por masë parandaluese. Ajo nuk duhet të përdoret shpesh, duhet të jetë proporcionale, e nevojshme dhe jo diskriminuese. Është kjo arsyeja që sapo merret një vendim i tillë, ju dhe mbrojtësi juaj duhet të njoftoheni menjëherë për udhërin e marrë dhe keni të drejtë të bëni ankesë në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i urdhërit. Kjo masë nuk zbatohet nëse jeni grua ose i/e mitur.

Është shkelje e të drejtave tuaja në rast se nuk mundësohet higjiena, kujdesi shëndetësor, veshja, ushqimi, mbajtja e librave, shprehja e mendimeve tuaja, ajrimi, takimet me avokatin mbrojtës, takimet me familjarët. Nëse ju vlerësoni se masa e marrë nuk është e drejtë, ju mund të bëni ankim në gjykatën e vendit ku ndodhet institucioni, brenda 10 ditëve nga marrja e masës. Këto të drejta nuk kufizohen edhe nëse jeni vendosur në mbikqyrje.

## 2.2 Procedura e transferimit dhe lejeve

### A mund të transferohem nga institucioni edhe pa pëlqimin tim?

Në disa raste, po. Ju nuk keni mundësi të caktoni vetë institucionin. Ju mund të transferoheni nga një institucion në tjetrin me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, bazuar në kërkesën e drejtorit të institucionit ku jeni vendosur, të kërkesës së prokurorit ose me kërkesën tuaj ose të një anëtarit të familjes tuaj.

Ju mund të transferoheni për një nga arsyet:

- kur çenohet rendi dhe siguria në institucion;
- kur rrezikohet jeta ose shëndeti juaj nga të dënuarit e tjerë;
- kur ka mbipopullim në institucion;
- për nevoja të hetimit dhe gjykimit;
- për arsye shëndetësore ose familjare;
- nëse duhet të zbatoni një program të formimit profesional;
- ka një urdhër ekzekutimi të prokurorisë për vendimet e formës së prerë të gjykatës.

Ju mund të kërkoni të transferoheni në një burg pranë vendbanimit të anëtarëve të familjes tuaj. Kërkesa mund të pranohet ose jo nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Kur kërkesa pranohet, ju transferoheni në një burg tjetër së bashku me sendet vetjake dhe dokumentacionin tuaj.

Në rast transferimi keni të drejtë të njoftoni menjëherë familjarët tuaj. Nëse kërkesa juaj për transferim nuk pranohet, ju keni të drejtë të ankoheni tek Ministri i Drejtësisë, brenda 15 ditëve nga marrja dijani e mospranimit të kërkesës suaj. Nëse dëshironi të bëni kërkesë ose ankesë për transferimin, kontaktoni me punonjës të personelit të institucionit që t'ju informojë për procedurën.

### **A mund të ndryshohet regjimi i institucionit ku jam vendosur?**

Po, ju mund të ndryshoni jo vetëm institucionin, por edhe regjimin e tij. Ai mund të ndryshojë, në varësi të sjelljes suaj. Bazuar në kërkesën tuaj, të prokurorit ose drejtuesit të institucionit, ose Ministrit të Drejtësisë ju mund të vendoseni në një institucion që ka një regjim tjetër. Ndryshimi i regjimit nga/për në burgun e sigurisë së lartë bëhet nga gjykata, ndërsa për institucionet me regjim të zakonshëm, të ulët ose për burgjet e hapura nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve.

Komisioni vlerëson rrezikshmërinë tuaj bazuar në raportin e vlerësimit të riskut që përgatit institucioni ku ju ndodheni. Komisioni vlerëson shumë faktorë si për shëmbull natyrën e veprës penale, rrezikun e arratisjes, personalitetin, sjelljen me të dënuarit e tjerë, sjelljen me viktimën, nëse jeni përdorues ose keni krijuar varësi nga lëndët narkotike, nëse keni patur përfitime të tjera gjatë kohës së kryerjes së dënimit. Në çdo rast që komisioni shqyrton kërkesën tuaj për ndryshimin e trajtimit, ju do të intervistoheni dhe gjetjet e intervistës janë pjesë e raportit të vlerësimit. Nëse ju nuk jeni dakord me vendimin e marrë, keni të drejtë të paraqisni ankesë në gjykatë.

**Kujtesë: Respektimi i rregullores, sjellja e mire, përfshirja në zbatimin e programit individual dhe veprimtarive në grup që zhvillon institucioni, vlerësohet nga Komisioni që vlerëson sjelljen tuaj.**

### **A mund të përfitoj nga leja e përkohshme?**

Po, ju keni të drejtë të bëni një kërkesë për leje shpërblyese ose të veçantë që mund t'ju lejojë të dilni përkohësisht nga burgu.

Gjatë vitit, ju mund të përfitoni deri në 20 ditë leje shpërblyese. Kërkesa juaj duhet të marrë përgjigje, pranimit ose jo brenda 7 ditëve nga paraqitja e saj. Nëse kërkesa pranohet, muaji dhe data e lejes caktohet duke mbajtur parasysh edhe planit vjetor të lejeve të përgatitur nga institucioni.



Leja e veçantë mund të jepet deri në 48 orë kur keni një nga këto nga arsye: sëmundje të rënda, që rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes vërtetuar me raport mjekësor, vdekje, lindje ose martesë në familje, dhënia e një provimi nëse ndiqni shkollën. Kjo leje mund të zgjatet deri në 24 orë të tjera për shkakë që duhet të provohen.

## **Cila është procedura për të përfituar leje?**

Leja shpërblyese mund jepet nga drejtori i institucionit, nëse jeni duke kryer dënimin në një burg të sigurisë së ulët ose të zakonshëm. Nëse jeni i vendosur në një burg të sigurisë së lartë, leja jepet nga Ministri i Drejtësisë, ose me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Leja është një e drejtë, por nuk do të thotë se e përfitoni sa herë e kërkonti atë. Ju mund të përfitoni leje shpërblyese nëse gjatë qëndrimit në institucion, ju respektoni rregullat, jeni të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të ri-integrimit tuaj, nuk paraqisni rrezikshmëri për shoqërinë. Për këtë, hartohet një raport vlerësimi i sjelljes tuaj.

Krahas sjelljes së mirë, ju duhet të keni kryer pjesën e dënimit që parashikon ligji. Drejtori i institucionit ose Ministri i Drejtësisë ose Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve vlerësojnë të gjitha këto kritere kur ju paraqisni një kërkesë për leje shpërblyese.

Kur leja është miratuar, drejtori verifikon nëse keni mjetet financiare për të udhëtuar ose veshjet e nevojshme, në varësi të moshës dhe stinës. Institucioni për aq sa është e mundur ju mundëson mjetet për udhëtim dhe veshjet.

## **Çfarë duhet të mbaj parasysh gjatë kohës që jam me leje?**

Gjatë kohës së lejes njoftohet policia e vendbanimit tuaj ose mund t'ju kërkohet që të mbani lidhje me të. Ju duhet të respektoni kushtet e caktuara, vendin e qëndrimit, ndryshe mund të riktheni në burg para përfundimit të lejes, në rast të mosrespektimit të kushteve. Kjo sjellje regjistrohet në dosjen tuaj dhe ju dëmton për të përfituar leje në të ardhmen. Nëse largoheni nga vendi i qëndrimit, ndaj jush mund të fillojë ndjekje penale.

Ju qëndroni përkohësisht jashtë burgut, për aq ditë ose orë sa është dhënë leja. Ju duhet të ktheheni në institucion në ditën dhe orën e caktuar në vendimin e dhënies së lejes.

***Mbani mend: Respektimi i kushteve dhe vendit të qëndrimit gjatë kohës që jeni me leje mundëson përfitimin e lejeve të tjera, të lirit me kusht, ose të uljes së dënimit.***

## Si duhet të veprojë, nëse leja nuk miratohet?

Në rast se kërkesa për leje shpërblyese ose leje të veçantë është refuzuar, ju ose përfaqësuesi juaj ligjor keni të drejtë të bëni ankesë. Në varësi të institucionit ku ndodheni, ankesa mund të bëhet pranë Ministrin të Drejtësisë ose në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijani për mosmiratimin e lejes.

Nëse jeni duke kryer dënimin në një institucion të sigurisë së ulët ose të zakonshme, ju mund të paraqisni ankesë te Ministri i Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë mund të mos ju japë të drejtë. Në këtë rast, ju mund të ankoheni në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijani për vendimin e mospranimit. Nëse jeni duke kryer dënimin në institucionet e sigurisë së lartë, ju mund të paraqisni ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja dijani e refuzimit të kërkesës.

## 2.3 Procedura e uljes së dënimit dhe lirimit me kusht

### Çfarë duhet të mbaj parasysh për të përfituar ulje dënimi?

Ulja e dënimit varet nga sjellja juaj. Zbatimi i rregullave, sjellja korrekte dhe pjesëmarrja aktive në veprimtaritë rehabilituese dhe ri-integruese ju ndihmojnë të përfitoni ulje dënimi.

Ulja e dënimit bëhet nga gjykata. Kërkesa mund të bëhet nga ju, ose mbrojtësi juaj ose drejtori i institucionit. Kur kërkesa miratohet, ju përfitoni ulje dënimi deri në 90 ditë në vit- nëse jeni duke vuajtur dënimin në burgje të sigurisë së ulët ose të zakonshme, ose deri në 45 ditë- nëse jeni në një burg të sigurisë së lartë. Ulja e dënimit përfitohet vetëm një herë në vit. Në vitin e parë, ju nuk mund të përfitoni ulje dënimi. E drejta për ulje dënimi lind vetëm pas 12 muajve nga fillimi i kryerjes së dënimit. Nëse kërkesa për ulje të dënimit bëhet për herë të parë, vlerësohet sjellja juaj gjatë 12 muajve të mëparshëm. Ju mund të përfitoni uljen tjetër pas 12 muajve nga ulja e fundit e përfituar, nëse keni një sjellje shumë të mirë gjatë kësaj periudhe.

**E rëndësishme: Është në të mirën tuaj të silleni mirë dhe të ndiqni rregulloren e burgut dhe të jeni pjesëmarrës aktiv në rehabilitimin, edukimin ose aktivitetet trajnuese të ofruara nga institucioni.**

### Në cilat rastet dhe kur mund të lirohem para kohe nga burgu?

Ligji parashikon lirimin me kusht. Lirimi me kusht është një e drejtë, por jo detyrimisht pranohet nga gjykata. Gjykata mban parasysh sigurinë publike dhe nëse lirimi juaj përbën rrezik për komunitetin. Ajo vlerëson raportin që kanë përgatitur komisioni i vlerësimit të rrezikshmërisë dhe shërbimi i provës. Disa faktorë që vlerësohen janë:

- lloji i veprës penale të kryer dhe rrezikshmëria e saj;
- periudha e vuajtur e dënimit;
- sjellja në institucion;
- përfshirja në programet e rehabilitimit në burg;
- vlerësimi i rrezikut që paraqisni në familje dhe shoqëri;
- marrëdhënien tuaj me viktimën dhe familjarët e saj;
- mundësitë e kryerjes së ndonjë vepre penale.

Nëse gjykata nuk pranon kërkesën për lirim, ju mund të ribëni kërkesë vetëm pasi të kenë kaluar 6 muaj nga dita e dhënies së vendimit të refuzimit.

Gjykata që ju ka dhënë vendimin e dënimit me burgim mund të vendosë një afat kohor brenda së cilit nuk lejohet lirimi me kusht. Kjo ndodh, nëse ju keni kryer një vepër penale kundër fëmijëve, grave shtatëzana, krim në familje, krim për motive të urrejtjes. Gjatë kësaj periudhe ju nuk mund të përfitoni lirim me kusht.

### **A mund të përfitoj lirim me kusht nëse jam dënuar për një krim të rëndë?**

Jo gjithnjë, ju nuk përfitoni lirim me kusht nëse jeni dënuar për një nga veprat e mëposhtme:

- vrasje për gjakmarrje;
- vrasje e funksionarëve publikë (prokuror, gjyqtar, avokat, deputet, ushtarak etj);
- vrasje e punonjësve të policisë së shtetit;
- vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare;
- marrëdhënie seksuale me të mitur me pasojë vdekjen ose vetvrasjen e fëmijës.

Si rregull, lirimi me kusht nuk lejohet për të dënuarit me burgim të përjetshëm. Në raste shumë të rralla kërkesa mund të pranohet. Në rast se kërkohet lirim me kusht nga të dënuarit me burgim të përjetshëm, gjykata mban parasysh këta faktorë:

- lloji i veprës penale;
- nëse jeni përsëritës në krim;
- të jetë kryer jo më pak se 35 vjet burgim;
- sjellja juaj gjatë kësaj periudhe duhet të jetë shembullore;
- qëllimi i dënimit është arritur.

### **Çfarë duhet të mbaj parasysh gjatë periudhës së liritimit me kusht?**

Ju do të mbikqyreni nga shërbimi i provës, pra duhet të mbani kontakte të rregullta me të. Gjykata vendos një ose disa detyrime. Për shembull, të mos frekuentoni vende të caktuara, të mos shoqëroheni me persona të caktuar, t'i nënshtroheni një programi trajtimi ose rehabilitimi, nëse jeni përdorues

të alkoolit ose të drogës etj. Në rast se nuk mbani kontakte me shërbimin e provës dhe nuk respektoni detyrimet, ose nëse kryeni një vepër penale me dashje gjatë periudhës së provës, ju riktheni në burg.

### **Si mund të përgatiten për lirin nga burgu?**

Para së të liroheni nga burgu, do të jeni nën mbikqyrjen e shërbimit të provës për një kohë të caktuar. Punonjësi i shërbimit të provës do ju ndihmojë. Së bashku do të përgatisni planin individual për përgatitjen për kthimin në komunitet. Punonjësi i shërbimit të provës do t'ju këshillojë për mënyrën e sjelljes, do t'ju ndihmojë të vendosni kontakte me familjarët dhe komunitetin, do t'ju japë informacion për shërbimet sociale, zyrat e këshillimit për punësim.

Nëse liroheni dhe nuk do të jeni nën mbikqyerje, përgatitja për lirim bëhet nga burgu. Gjashtë muaj para se të liroheni, punonjësi social në institucion fillon së bashku me ju përgatitjen për lirim. Kërkonte të merrni informacionin që ju duhet prej tij.

### **Çfarë ndodh nëse pas lirit nuk kam mjete financiare apo vend ku të shkoj?**

Nëse nuk keni mundësi të paguani shpenzimet e transportit ose veshje të përshtatshme kur të dilni, ju mund të kërkonte ndihmë nga institucioni. Ai do të sigurojë mbulimin e shpenzimeve të transportit deri në vendbanimin tuaj dhe veshjet e përshtatshme.

Në rast se nuk keni shtëpi, familje, të afërm ku mund të qëndroni, drejtuesi i institucionit e adreson këtë çështje të organet e qeverisjes vendore të vendbanimit tuaj. Ju mund të përfitonit strehim nga programet e strehimit që zbatojnë njësitë e qeverisjes vendore.

Nëse jeni në kërkim të punës, institucioni e referon rastin në zyrat e këshillimit për punësim. Vërtetimet ose dëshmitë që keni marrë nga trajnimet ose formimet profesionale të kryera mund të jenë të dobishme.

Nëse jeni shtetas i huaj, drejtuesi i institucionit njofton ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.

## **3. DISIPLINA NË BURG**

### **3.1 Rregullat në institucion dhe respektimi i tyre**

Institucioni ku ju vuani dënimin ka rregulloren e vetë, ajo përcakton veprimet e lejuara dhe të ndaluara, rregullat dhe oraret e veprimeve. Njohja dhe zbatimi i rregullores është i nevojshëm.



## **Çfarë ndodh nëse nuk respektoj ndonjë nga rregullat në institucion?**

Sjelljet e ndaluara gjenden në rregulloren e institucionit. Disa prej tyre përfshijnë dëmtimin me dashje të sendeve të burgut ose të të burgosurve të tjerë, përdorimin e fjalëve të pahijshme e fyese ndaj personave të tjerë, dhunën fizike ose psikologjike ndaj të burgosurve të tjerë, sjelljen agresive ndaj personelit ose të burgosurve të tjerë, mbajtjen, përdorimin dhe qarkullimin e sendeve të ndaluara si celular, përdorimin e lëndëve narkotike, e pijeve alkoolike, moskryerjen e pastrimit personal të dhomës ose mjediseve të përbashkëta, vënien zjarr të orendive në dhomë etj.

Drejtoria e institucionit mund të mos fillojë një procedim disiplinor ndaj jush, por mund të ndërmjetësojë për të normalizuar marrëdhëniet tuaj me të burgosurin tjetër në rast dëmtimi të sendeve të të tjerëve, por edhe ky veprim ndikon në vlerësimin e sjelljes tuaj.

Për sjelljet në shkelje të rregullores, zbatohen masa disiplinore dhe në raste të caktuara mund të përdoret forca.

**E rëndësishme : Është në të mirën tuaj që të adresoni shqetësimet te personeli, të zgjidhni konfliktet që mund të lindin me ndërmjetësim dhe mirëkuptim dhe të respektoni gjithnjë rregulloren!**

## **3.2 Procesi disiplinor**

### **Nëse ka nisur një proces disiplinor, çfarë duhet të bëj?**

Nëse fillon një proces disiplinor ndaj jush, ju duhet të njoftoheni se cila sjellje është vlerësuar si shkelje. Ju mund të dënoheni për sjelljen që quhen shkelje nga ligji dhe rregullorja. Për shkeljen e kryer jepet vetëm një masë disiplinore.

Para fillimit të procesit disiplinor, ju duhet të njoftoheni, keni të drejtë të dëgjoheni, të verifikoni atë çfarë thuhet për ju. Njoftimi për ditën dhe orën e dëgjimit tuaj duhet të jetë me shkrim. Nëse dëshironi, ju mund të kërkonit si dëshmitar personin që ka parë ose ka informacion për ngjarjen.

Nëse ju refuzoni marrjen e njoftimit për mbledhjen e komisionit disiplinor, kjo nuk ndalon vijimin e procesit. Dy persona të tjerë që nuk kanë lidhje me ngjarjen vertetojnë marrjen e njoftimit nga ana juaj.

Ju keni të drejtë të mbroheni vetë ose të kërkonit mbrojtës. Drejtuesi i institucionit duhet ta mundësojë atë. Nëse jeni shtetas i huaj, drejtuesi i institucionit mundëson një përkthyes, nëse është e nevojshme. Ju keni të

drejtë të informoheni në një gjuhë që është e kuptueshme për shkeljen dhe masën që propozohet. Komisioni duhet t'ju japë kohë dhe lehtësi të mjaftueshme për të parashtruar pretendimet dhe provat tuaja. Vendimi i komisionit duhet të jetë i arsyetuar. Ai merret brenda 20 ditëve nga dita e konstatimit të shkeljes. Ju keni të drejtë të njiheni me vendimin dhe të paraqisni ankesë, nëse nuk jeni dakord me të.

### 3.3 Masa disiplinore

#### **Nëse gjendem fajtor për shkeljet, çfarë masash mund të zbatohen ndaj meje?**

Në rast se provohet shkelja, komisioni disiplinor mund të zbatojë një nga masat e mëposhtme:

- këshillim individual;
- përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë;
- përjashtim nga ajrosja në grup deri në 10 ditë;
- përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë;

Kur komisioni vendos për përjashtimin nga veprimtaritë e përbashkëta, ju do të qëndroni në një dhomë veçmas nga të burgosurit e tjerë, deri në përfundimin e afatit të caktuar.

Nëse jeni grua, ju mund të përjashtoheni nga veprimtaritë e përbashkëta për jo më shumë se 7 ditë, ndërsa nga ajrimi në grup deri në 5 ditë. Nëse jeni shtatzënë ose keni fëmijë për t'u kujdesur në institucion atëherë jepet vetëm masa e këshillimit. Nëse jeni person me aftësi ndryshe ose keni çrregullime të shëndetit mendor dhe nëse mjeku shprehet se kjo masë ndikon në përkeqësimin e gjendjes suaj, përjashtimi nga veprimtaritë e përbashkëta nuk mund të jepet. Masa disiplinore e dhënë shënohet në dosjen personale.

#### **Nëse dënohem me masën e përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta, çfarë duhet të mbaj parasysh?**

Ju do të veçoheni nga të burgosurit e tjerë, pasi mjeku i institucionit ju ka vizituar dhe ka hartuar raportin për gjendjen tuaj fizike dhe mendore. Dhoma ku do të qëndroni duhet të ketë kushtet e dhomave si për të dënuarit e tjerë. Gjatë kohës që jeni me masë, mjeku duhet të kontrollojë shëndetin tuaj çdo ditë. Ju keni të drejtë të kontaktoni me Avokatin e Popullit, me mekanizmin për parandalimin e torturës, të dilni në ajrim të paktën 1 orë në ditë, të takoheni me familjarët tuaj të paktën një herë gjatë kësaj periudhe.





## A ka dënime që mund të më shkelin të drejtat?

- Po, për shembull, ju nuk mund të:
- trajtoheni në mënyrë poshtëruese, denigruese ose ndaj jush të ushtrohet torturë;
- privoheni nga gjumi dhe ushqimi;
- dënoheni në grup;
- vendoseni në dhomë izolimi pa ajrim, pa ndriçim dhe ngrohje;
- dënoheni pa afat të caktuar ose tej afateve të caktuara në ligj;
- lidheni me pranga ose me zhinxhirë;
- provoni forcën fizike si ndëshkim.

### 3.4 E drejta e ankimit

#### A mund të ankoem për një masë disiplinore të dhënë?

Po, ju mund të ankoheni në Komisionin e Apelimit. Ky komision është i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Kontaktoni me personelin t'ju pajisë me formatin e ankimit dhe pasi e plotësoni, paraqiteni atë brenda 15 ditëve.

Nëse vendimi i Komisionit të Apelimit nuk ju jep të drejtë, ju mund të ankimoni vendimin në gjykatë brenda 15 ditëve, nga njoftimi me shkrim i tij. Për përgatitjen e ankimit mund të kërkonti ndihmë juridike falas.

## 4. E DREJTA PËR KËRKESË DHE ANKESË

### 4.1 E drejta për të paraqitur kërkesë/ankesë

#### Ku mund të paraqes një kërkesë ose ankesë dhe çfarë duhet të bëj nëse të drejtat e mia janë shkelur?

Ju keni të drejtë të paraqisni një kërkesë ose ankesë individuale ose në grup për të kërkuar zbatimin e të drejtave tuaja, të ligjit ose rregullores së institucionit.

Ankesa paraqitet, sapo vlerësoni se e drejta juaj është shkelur. Ankesa bëhet me shkrim ose në raste përjashtimore me gojë. Në rast të ankimit me gojë, ai regjistrohet në një procesverbal. Ju keni të drejtë të informoheni për mundësinë e takimeve me drejtorin e institucionit ose personelin përgjegjës për çështje në interes të tij ose që përbëjnë shqetësim.

Fillimisht, kërkesën ose ankesën paraqiteni te drejtori i institucionit, me pas te Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, ministri i Drejtësisë dhe Komisioni

mbikqyrës i ekzekutimit të vendimeve penale, që funksionin pranë ministrit të Drejtësisë. Ju mund ta paraqisni ankesën në të njëjtën kohë te cilido organi shtetëror ose organizate jofitimprurëse brenda dhe jashtë vendit. Lista e institucioneve, individëve, organizatave që ju mund t'i drejtoheni është parashikuar në ligj. Një listë të institucioneve dhe organizatave të rëndësishme dhe detajet e kontaktit me to, gjenden në shtojcën bashkëlidhur, në fund të kësaj broshure.

Mos hezitoni të kontaktoni me personelin e institucionit për të marrë informacionin që ju nevojitet.

**Mbani mend: Mos hezitoni të kontaktoni me personelin e institucionit për të marrë informacionin që ju nevojitet!**

### **Kush mund të paraqesë kërkesën ose ankesën tuaj?**

Ankesën ose kërkesën mund ta paraqisni vetë, nëpërmjet një mbrojtësi ose një familjari. Ju ose familjarët tuaj mund të kërkonin ndihmë nga personeli, të kërkonin avokatë ose të kërkonin këshilla ligjore rreth përgatitjes së ankesave dhe procedurave të apelimeve. Personeli i institucionit ka për detyrë t'ju mundësojë mjetet e nevojshme për paraqitjen e kërkesës dhe ankesës.

Kërkesa ose ankesa juaj regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe drejtori i institucionit ngarkon punonjësën përkatës për trajtimin e saj dhe kthimin e përgjigjes. Mbani parasysh që kërkesat për çështje të kujdesit shëndetësor i drejtohen mjekut në mënyrë direkte, mbahen prej tij dhe trajtohen prej personelit mjekësor në mënyrë konfidenciale. Kjo praktikë është përcaktuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës.

### **Cilat janë afatet e paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave dhe të kërkesave?**

Afatet e paraqitjes së kërkesave dhe ankesave janë të ndryshme edhe afatet e shqyrtimit të tyre mund të jenë të ndryshme. Si rregull, shqyrtimi i ankesës dhe kërkesës suaj duhet të bëhet sa më parë, por jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja e tyre.

### **Si duhet të veprojnë nëse nuk marr përgjigje ose nuk jam i kënaqur me mënyrën e trajtimit të kërkesës ose ankesës?**

Nëse nuk merrni përgjigje për kërkesën ose ankesën brenda afatit ose nuk jeni dakord me përgjigjen e dhënë nga drejtuesi i institucionit, ju mund të ankoheni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve brenda 30 ditëve nga marrja e saj. Nëqoftëse, nuk mbeteni të kënaqur me përgjigjen ose në



rast se nuk merrni përgjigje brenda 30 ditëve, ju keni të drejtë të bëni ankim në gjykatën e rrethit ku ekzekutohet vendimi.

Kërkesat dhe ankesat mund t'i formuloni sipas modeleve të miratuara. Ato gjenden në institucion. Ju mund të kërkonti që institucioni t'ju sigurojë mjetet e nevojshme për përgatitjen e kërkesave ose ankesave, ose t'ju ofrojë modelet e miratuara të paraqitjes së kërkesave dhe ankesave.

## 4.2 Komunikimi me institucionet e të drejtave të njeriut

### A ka institucione dhe organizata të pavarura që mund t'i drejtohem?

Janë disa institucione dhe organizata të cilave mund t'i drejtoheni me kërkesë ose ankesë. Një listë të disa prej tyre e keni si shtojcë në fund të kësaj broshure, disa prej tyre janë si më poshtë:

- Avokati i Popullit dhe Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ju mund t'i drejtoheni këtyre institucioneve me letër, me e-mail ose t'i telefononi. Institucioni ku ndodheni ka detyrim të afishojë në vende të dukshme adresat, numrat e telefonave dhe adresat elektronike të institucioneve dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e njeriut, si dhe t'ju japë informacionin që kërkonti.

### 4.2.1 Komunikimi me Avokatin e Popullit

#### Përse mund t'i drejtohem Avokatit të Popullit?

Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë e shtetasve nga veprimet e paligjshme të administratës, përfshirë edhe të personelit të burgjeve. Ai/ ajo trajton rastet e shkeljes së të drejtave të konstatuara gjatë vizitave në burgje, ose kur merr letra ose ankesa nga të dënuarit për të drejtat që shkelen, për kushtet jo të mira dhe trajtimin e tyre nga ana e personelit.

Avokati i Popullit verifikon gjendjen dhe nëse gjen shkelje rekomandon masa për ta përmirësuar atë. Avokati i Popullit nuk ka mundësi të zgjidhë çështjen tuaj, por bën rekomandime për zgjidhjen e tij/saj dhe respektimin e të drejtave të të burgosurve. Nëse rekomandimi nuk zbatohet, Avokati i Popullit paraqet raport për zbatimin e rekomandimeve të bëra në Kuvend.

Pranë Avokatit të Popullit funksionon Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin

e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës. Ky mekanizëm viziton burgjet për të parë nga afër kushtet e trajtimit të të dënuarve dhe respektimin e të drejtave të të dënuarve. Për problemet e gjetura bën rekomandime për zgjidhjen e tyre.

**E rëndësishme: Institucioni i Avokatit të Popullit është institucion i pavarur dhe ndjek respektimin e të drejtave të personave në vendet e paraburgimit dhe në burgje.**

### **Si mund të komunikoj me Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës?**

Ju mund të dërgoni kërkesë ose ankesë, vetë ose mes përfaqësuesit ligjor, ose nëpërmjet organizatave që monitorojnë burgjet. Ju mund të kontaktoni me Mekanizmin Kombëtar gjatë vizitave në institucion. Takimet me përfaqësuesit e tij mund të zhvillohen në çdo kohë dhe pa mbikëqyrje nga stafi i institucionit. Mekanizmi është shpesh i pranishëm në burgje. Në mjediset e burgjeve janë të afishuara numrat e telefonit për të komunikuar me të.

### **4.2.2 Komunikimi me Komisionerin e Mbrojtjes nga Diskriminimi**

#### **Në cilat raste mund t'i drejtohem Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi?**

Ju mund t'i drejtoheni komisionerit nëse ndjeheni të diskriminuar nga personeli i institucionit ose të dënuarit e tjerë dhe administrata nuk merr masa të ndërpresë këtë gjendje. Një nga mënyrat e komunikimit është duke drejtuar ankesë ose gjatë vizitës në institucion të Komisionerit. Ju mund të telefononi në numrin jeshil, pa pagesë: 0800 06 06, ose dërgoni një letër ose e-mail.

Komisioneri, mbi bazën e ankesës tuaj ose të një grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar mund të kryejë një hetim administrativ për të verifikuar ankesën dhe nëse gjen diskriminim ai ka të drejtë t'i vendosë gjoba institucionit ose individit që diskriminon.

Nëse keni nevojë për informacion më të detajuar, komunikoni me personelin institucionit.

#### **Çdo të thotë që i dënuari të trajtohet pa diskriminim?**

Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë që synon ose shkakton pengesa në ushtrimin e të drejtave e lirive themelore, në



mënyrë të njëjtë si të tjerët. Të trajtoheni pa diskriminim do të thotë që trajtoheni në mënyrë të barabartë, pa dallim për shkak të përkatësisë ose shoqërimit me një grup shoqëror që përbën pakicë.

Shkaqet e diskriminimit janë të shumta dhe ju mund të diskriminoheni për një ose disa nga shkaqet si: gjinia, raca, shtetësia, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, mosha, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicioni gjenetik, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

**Kujdes: Jemi të ndryshëm, por të barabartë. Përpiquni që me sjelljet, veprimet ose mosveprimet tuaja, të respektoni të gjithë, të dënuar ose personale!**

### **Cilat mund të jenë format e diskriminimit në burg?**

Diskriminimi mund të bëhet me çdo formë nga personeli ose të dënuar e tjerë. Format më të shpeshta janë fjalët, shprehjet, veprimet, veçimi, vënia në lojë, fyerjet, nxitja e të tjerëve për të fyer një të dënuar për një nga shkaqet e sipërcituara, detyrimi për të bërë pastrimet dhe shërbimet në dhomë dhe në ambjentet e tjera të burgut etj.

Disa grupe shoqërore janë më shpesh viktimat të diskriminimit si romët, egjiptianët, gratë, të huajt, personat me orientim seksual të ndryshëm, personat në pozita të ndryshme sociale. Një i dënuar mund të jetë viktimë për më shumë se një prej shkaqeve të cituara.

### **Çfarë mund të bëj nëse ndihem i diskriminuar?**

Nëse gjykoni se personeli i institucionit ju diskriminon, ose lejon që një i dënuar tjetër t'ju diskriminojë, kontaktoni me drejtuesin e institucionit duke i kërkuar ndërprerjen e sjelljes ose qëndrimeve diskriminuese. Nëse sjellja diskriminuese nuk ndalon edhe pas ankesës së paraqitur, ju keni të drejtë të paraqisni ankesë pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për shkelje të Kodit të Etikës së punonjësit dhe diskriminim. Siç përmendëm më lart, ju keni të drejtë t'i drejtoheni edhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## **4.3 Komunikimi me organizatat e të drejtave të njeriut**

Në Shqipëri ka disa organizata me përvojë në fushën e të drejtave të njeriut. Disa prej tyre trajtojnë të drejtat e të paraburgosurve dhe të të dënuarve, të

tjera organizata trajtojnë të drejtat e grave ose të fëmijëve, ose të drejtat e shtetasve në sistemin e drejtësisë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është një nga organizatat monitoruese me përvojë të gjatë në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht të të drejtave dhe trajtimit të paraburgosurve dhe të të dënuarve. Ajo ofron këshillim ligjor, trajton letra dhe ankesa të personave që ndodhen në burgje. Nëse keni shqetësime në lidhje me respektimin e të drejtave tuaja, ju mund të shkruani një letër, kërkesë ose ankesë në adresë të kësaj organizate ose organizatave të tjera. Një listë të organizatave që punojnë në burgje ju mund ta merrni nga drejtori i institucionit.

## 4.4 Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT)

Burgjet në Evropë dhe në Shqipëri vizitohen hera-herës nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT). Gjatë vizitave dhe takimeve me të dënuarit, ky Komitet vlerëson kushtet dhe trajtimin e personave të ndaluar, arrestuar në polici, vendet e paraburgimit, burgjet, qendrat ku mbahen të huajt, etj.

Përfaqësues të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës gjatë vizitave në burg takohen me personelin dhe të dënuarit dhe në fund të vizitës hartojnë rekomandime që duhet të plotësohen. Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës nuk trajton kërkesa dhe ankesa konkrete të të dënuarve, por bazuar në problemet që të burgosurit paraqesin, ata zhvillojnë vizita në burgje dhe bëjnë rekomandime për përmirësimin e kushteve dhe respektimin e të drejtave të të burgosurve.

## 5. AKSESI NË GJYKATË

### 5.1 Çështjet që mund të adresohen në gjykatë

#### Për çfarë lloj çështjesh i dënuari mund të shkojë në gjykatë?

Ligji për trajtimin e të dënuarve dhe kodi i procedurës penale mundëson një numër të madh rastesh për të cilat një i dënuar i drejtohet gjykatës. Ankesat tuaja gjatë kryerjes së dënimit trajtohen nga gjykata e vendit ku ndodhet institucioni.

Më poshtë po rendisim disa çështje për të cilat mund të shkoni në gjykatë. Sipas ligjit dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ju keni të drejtë:

- të trajtoheni me dinjitet;
- të mos torturoheni, të keqtrajtoheni ose të mos trajtoheni në mënyrë poshtëruese;



- jeta juaj në burg nuk duhet të rrezikohet nga sjelljet e personelit dhe të dënuarve të tjerë;
- shëndeti juaj nuk duhet të rrezikohet për shkak të mungesës së kujdesit shëndetësor, trajtimit jo të duhur ose mungesës së medikamenteve;
- të mbron privatësinë tuaj të njohur nga ligji;
- të mbani lidhje me mbrojtësit tuaj dhe të mos t'ju mohohet e drejta e mbrojtjes nëse nuk keni mundësi financiare;
- të mos dënoheni me masa disiplinore për të cilat nuk jeni dëgjuar ose nuk keni pasur mundësi të mbroheni;
- të përfitoni leje shpërblyese ose të veçantë, nëse plotësoni kriteret që cakton ligji;
- të kërkonti ulje dënimi, nëse mendoni se plotësoni kriteret ligjore;
- të kërkonti ndryshimin e regjimit;
- të mos vendoseni në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, nëse nuk ka shkaqe për një regjim të tillë;
- të bëni ankim kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve, Komisionit të Apelit, vendimit ose urdhërit të drejtorit të institucionit, Drejtorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Drejtësisë;
- të kërkonti lirim me kusht, nëse mendoni se plotësoni kriteret ligjore;
- të kërkonti dëmshpërbim për dëmin e shkaktuar nga sjelljet e personelit të burgut në shkelje të ligjit.

Nëse këto të drejta nuk respektohen, ju jeni viktimë dhe keni të drejtë t'i drejtoheni gjykatës. Kushtet jo të mira në burgje mund të çojnë në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila ndalon torturën, trajtimin çnjerëzor ose degradues. Në vendin tonë ka disa raste që të burgosurit janë ankuar dhe kanë fituar të drejtën në gjykatat shqiptare dhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje të Konventës nga personeli i burgjeve.

**E rëndësishme: Para se t'i drejtoheni gjykatës, është mirë të zgjidhni kërkesat ose problemet me personelin e institucionit dhe me organet që kontrollojnë atë!**

### **Nëse unë mendoj që mbahem pa të drejtë në burg, si mund t'i drejtohem gjykatës?**

Nëse mendoni se ka një gabim në të dhënat tuaja dhe mbaheni padrejtësisht në burg ose dënimi është kryer dhe ju nuk jeni liruar ende, kontaktoni menjëherë drejtuesin e institucionit.

Ju mund të adresoni kërkesën tuaj në gjykatë, në situatat e mëposhtme:

- nuk jeni personi ndaj të cilit ka një vendim për ekzekutimin e dënimit me burgim;
- nuk ka një vendim për arrestimin dhe dërgimin tuaj në burg;
- jeni dënuar në vend të një personi tjetër për gabim në emër;
- dënimi i caktuar në vendim është kryer dhe duhet të liroheni;
- mbaheni në burg për një vepër për të cilën e keni kryer dënimin më parë;
- vepra e kryer është amnistuar;
- janë bërë gabime në llogaritjen e periudhës që keni qenë në arrest në burg, ose të një dënimi të shlyer më parë;
- llogaritja e ndryshimit të dënimit nga gjobë në dënim me burgim është bërë gabim.

### **A mund të kem akses në gjykatë, duke qenë i burgosur?**

Po, ju mund të merrni vetë pjesë në procesin gjyqësor ose mund të përfaqësoheni nga mbrojtësi tuaj. Të paktën 10 ditë para seancës, ju duhet të njoftoheni nga gjykata për datën e seancës që do të trajtojë kërkesën tuaj. Ka rëndësi që kur të hartohet kërkesa të shënoni adresën e saktë të institucionit ku ndodheni dhe të mbrojtësit tuaj, përfshirë numrin e telefonit si dhe një adresë e-maili të tij. Prania e mbrojtësit në seancë është e detyrueshme, por edhe ju mund të dëgjoheni.

## **5.2 Mbrojtja juridike**

Gjatë qëndrimit në institucion, mund të keni nevojë për këshilla ligjore, ose për mbrojtje të specializuar. Ju keni të drejtë të zgjidhni mbrojtësin ose të afërmit tuaj mund ta bëjnë këtë zgjedhje për ju duke mbuluar edhe pagesën për këtë shërbim.

Në disa raste mbrojtja është e detyrueshme si për shembull, për fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, personat e akuzuar për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim mbi 15 vjet, për veprat penale të korrupsionit, terrorizmit etj. Në këto raste, nëse nuk keni mbrojtjes të zgjedhur ose keni mbetur pa mbrojtës, mbrojtësi caktohet nga gjykata dhe ai paguhet nga shteti.

Nëqoftëse nuk përfshihen në kategorinë e personave që përfitojnë mbrojtje të detyrueshme dhe jeni në pamundësi financiare për të pasur një mbrojtës të zgjedhur prej jush, organi procedues ju cakton një mbrojtës nga lista e vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas. Shpenzimet e mbrojtjes mbulohen nga shteti.

Ju keni gjithashtu të drejtë që të komunikoni vetëm për vetëm me avokatin tuaj dhe të mbani dokumente që lidhen me procedurat ligjore.





## **A mund të marr ndihmë juridike falas kur jam në institucion?**

Po, ju mund të merrni informacion për të drejtat, detyrimet tuaja gjatë procesit gjyqësor ose për zgjidhjen e çështjes në gjykatë, ose zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim. Nëse keni nevojë të hartoni një kërkesë, letër për një institucion ose t'i drejtoheni gjykatës, kërkojini punonjësit të institucionit t'ju ofrojnë kontaktet e zyrës për ndihmën juridike falas që ofrohet nga shteti.

## **A përfitojnë të gjithë të dënuarit ndihmë juridike falas?**

Jo, vetëm të dënuarit që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare përfitojnë nga ndihma juridike falas, si dhe ata që sipas ligjit kanë mbrojtje të detyruar si për shembull të miturit, personat me aftësi të kufizuara, dhe disa kategori që përcaktohen në ligj si, viktimat e dhunës seksuale, viktimat e dhunës në familje etj.

Ndihma juridike falas jepet në një nga format e mëposhtme:

- dhënia e informacionit për të drejtat dhe detyrimet tuaja, për ushtrimin e tyre në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- dhënia e këshillimit për mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje juridike;
- dhënia e këshillimit për procedurat dhe zgjidhjen e konfliktit me anë të ndërmjetësimit;
- dhënia e ndihmës në hartimin e kërkesave për institucionet ose për gjykatën;
- përfaqësimi përpara organeve administrative;
- përgatitja e akteve, ofrimi i këshillimit, përfaqësimi dhe mbrojtja para gjykatës.
- 

## **Si duhet të veprojmë për të përfituar ndihmë juridike falas?**

Ju mund të bëni një kërkesë me gojë ose me shkrim. Ju duhet të nënshkruani një vetëdeklarim se nuk keni të ardhura të mjaftueshme dhe dërgoni atë bashkë me dokumentet që vërtetojnë këtë gjë. Ndihma juridike në formën e dhënies së informacionit ose këshillave, si rregull ofrohet menjëherë sapo të mbërrijë kërkesa juaj. Kjo ndihmë mund të jepet nga punonjësit të trajnuar ose organizatat jofitimprurëse të autorizuara ose klinikat ligjore pranë fakulteteve.

Ju duhet të aplikoni për ndihmë juridike duke plotësuar një formular të miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Formularët gjenden në formë elektronike në faqen e internetit të drejtorisë së ndihmës juridike dhe pranë zyrave të ndihmës juridike të ngritura në disa bashki. Telefono në numrin falas: 08001010 ose kontakto me juristin në institucion për t'ju asistuar.

Nëse ju keni nevojë për një mbrojtës pa pagesë, ju duhet të bëni kërkesë pranë prokurorisë ose gjykatës.

Kërkesa paraqitet nga ju, një përfaqësues ligjor, ose një i afërm i pajisur me prokurë. Kërkesa dërgohet me postë pranë gjykatës ose prokurorisë përpara fillimit të procesit gjyqësor, por ajo mund të paraqitet edhe në fillim ose në çdo fazë të procesit gjyqësor- deri kur nuk është deklaruar e mbyllur faza e hetimit gjyqësor.

Për këtë lloj kërkesë ju nuk paguani, tarifa mbulohet nga shteti. Për të plotësuar formularin e vetëdeklarimit dhe për të mbledhur dokumentet, kontaktoni me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas ose me Zyrën për Ndihmë Ligjore Falas që gjenden pranë Ministrisë së Drejtësisë.

### 5.3 Kërkesa në Gjykatë Kushtetuese

#### Kur mund t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese?

Ju mund t'i drejtoheni Gjykatës Kushtetuese kur një vendim gjyqësor i dhënë ndaj jush çënon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Para së të ankoheni në këtë Gjykatë, çështja juaj duhet të ketë kaluar në të gjitha shkallët e gjykatave. Pra, kërkesa duhet të ketë nisur nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese ju nuk mund të shkoni vetë, por duhet të përfaqësoheni nga një avokat mbrojtës.

### 5.4 Kërkesa në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

#### Cilat nga të drejtat që mbrohen nga Konventa duhet të njihen nga një i dënuar?

Konventa ndër të tjera mbron të drejtat e mëposhtme:

- të drejtën për jetën;
- të drejtën për proces të rregullt gjyqësor në çështje civile dhe penale;
- të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare;
- lirinë e shprehjes;
- lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë;
- të drejtën për një rekurs efektive;
- të drejtën për gëzim paqësor të pronës;
- të drejtën për të votuar.



Konventa ndalon:

- torturën, trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtëruës;
- ndalimin arbitrar dhe të paligjshëm;
- diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë.

## **Kur dhe si mund t'i drejtohem Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj)?**

Ju keni të drejtë t'i drejtoheni Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) nëse mendoni se jeni viktimë e shkeljes së të drejtave që parashikon Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nëse mendoni se ka shkelje të Konventës, ju mund t'i drejtoheni GjEDNj, pasi të keni ndjekur çështjen në gjykatat shqiptare, madje edhe në Gjykatën Kushtetuese nëse bëhet fjalë për të drejtat e njeriut.

Ju keni të drejtë të bëni kërkesën në GjEDNj brenda 6 muajve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë në Gjykatën më të lartë brenda vendit. Kërkesa juaj nuk mund të pranohet nga GjEDNj në rast se kanë kaluar më shumë se 6 muaj nga vendimi i formës së prerë.

Për t'ju drejtuar GjEDNj, kërkonin ndihmën e një mbrojtësi ligjor. Ai/ajo do të përgatisin aplikimin për ju. Një informacion praktik mbi kriteret e pranimit të aplikimit në GjEDNj në gjuhën Shqipe është i disponueshëm në [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int).

Formulari i ankimit i plotësuar dhe i firmosur, së bashku me dokumentet mbështetëse duhet të dërgohen me postë në adresën e mëposhtme:

*The Registrar*  
*European Court of Human Rights Council of Europe*  
*F-67075 Strasbourg cedex*

# SHTOJCA

## KONTAKTE TË NEVOJSHME

### Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Adresa: Rruga "Zef Serembe", Tufinë,  
Tiranë  
Tel: +355 4 631 5755,  
Fax (n): 00355 4 222 82 92  
Informacion/Whatsapp: 068 60 57100  
E-mail: [info@dpbsh.gov.al](mailto:info@dpbsh.gov.al)

### Ministria e Drejtësisë

Telefon: 04 2 259 389  
Email: [info@drejtesia.gov.al](mailto:info@drejtesia.gov.al)  
Adresa: bulevardi "Zog i parë" Tiranë

### Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Adresa:  
Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5,  
Kodi postar 1001, Tiranë  
E-mail: [info@idp.al](mailto:info@idp.al)  
